

SKEDË INFORMATIVE MBI DOKUMENTACIONIN PËR PENSION SOCIAL

- Kushtet për të përfituar një pension social, sipas nenit 5/1, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar, janë:
 1. Moshë 70 vjeç;
 2. Qëndrimi i përhershëm në Shqipëri, të paktën për 5 vitet e fundit;
 3. Nuk plotësohen kushtet për asnjë pension nga skema e detyrueshme;
 4. Nuk ka të ardhura ose janë më të pakta se një pension social.

- Dokumentacioni i detyrueshëm për të përfituar pension social, është si më poshtë:

Nr.	EMËRTIMI I DOKUMENTACIONIT TË DETYRUESHËM	INSTITUCIONI QË LËSHON DOKUMENTIN
1.	Fotokopje e Kartës së identitetit;	Vetë personi
2.	Certifikatë familjare;	Zyra e Gjendjes Civile
3.	Deklaratë për gjendjen social-ekonomike;	Vetë personi
4.	Vërtetim nga zyra e gjendjes civile, që është banor në Shqipëri për të paktën 5 vite, nga koha që paraqet kërkesën;	Zyra e Gjendjes Civile/Njësia Bashkiake/Njësia Administrative
5.	Vërtetim nga organet tatimore, nëse ushtron ose jo veprimtari ekonomike;	Drejtoria Rajonale e Tatim – Taksave
6.	Certifikatë pronësie dhe/ose akti i marrjes në pronësi/në përdorim të tokës;	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
7.	Vërtetim për ndihmën ekonomike;	Zyra e Shërbimit Social
8.	Deklaratë nëse je aksioner apo bashkëpronar në aktivitete ekonomike/ pasuri të patundshme, që nxjerr të ardhura.	Vetë personi

- a. Përfituesi duhet të paraqesë një herë në vit deklaratën për gjendjen social- ekonomike;
- b. Pensioni social tërhiqet nga përfituesi çdo muaj;
- c. Pagesa e pensionit social ndërpritet në rast se nuk tërhiqet, në qendrat e përcaktuara të pagesës;
- d. Pensioni social mbyllet kur konstatohet se ka të dhëna jo të vërteta, lidhur me kushtet ligjore të përfitimit;
- e. Pensioni social nuk ndërpritet në rastet kur përfituesi është për kurim në spital.